

**Pasqyrimi i krimit të
organizuar në shtatë
gazeta të përditshme
në vend
(janar-mars 2005)**

❖ Hyrje

Krimi i organizuar është kthyer në një nga temat më të diskutuara në vend, në të gjitha llojet e mediave. Përhapja e tij në shumë fusha të jetës së vendit si dhe rëndësia që ka lufta kundër kësaj plaje për të ardhmen e Shqipërisë e kanë kthyer informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për këtë çështje në një detyrim, sidomos për median që shërben si hallkë lidhëse mes publikut dhe aktorëve të tjerë. Për këtë arsye, është e rëndësishme që të njihemi me panoramën që ofron media për këtë temë, mangësitë dhe anët e mira që ka mundur të transmetojë te publiku i gjerë.

Në këtë kuadër, u monitoruan shtatë gazeta të përditshme shqiptare për periudhën janar-mars 2005. Gazetat e përzgjedhura ishin: Shekulli, Panorama, Korrieri, Tema, Koha Jonë, Metropol dhe Gazeta Shqiptare. Arsyeja kryesore e përzgjedhjes së këtyre mediave ishte influenca dhe popullariteti i tyre te publiku. Meqenëse në Shqipëri nuk ekziston asnjë mundësi zyrtare për të pasur të dhëna për popullaritetin dhe ndikimin e secilës media në treg dhe në opinionin publik, kjo përzgjedhje është bërë duke u mbështetur në kërkime tona të mëparshme si dhe në përvojën e përgjithshme të fituar në kontaktet e vazhdueshme me përfaqësuesit e medias.

Monitorimi u përqendrua kryesisht te artikujt që pasqyrojnë veprimtarinë ose personat që konsiderohen të lidhur me krimin e organizuar, duke u përqendruar te krahasimi i hapësirës që zënë këta artikuj në këto botime në krahasim me temat e tjera, në nëndarjet kryesore të këtyre temave, tiparet më të dukshme që bashkojnë artikujt, si dhe dallimet e tyre, të metat në pasqyrim, forma e paraqitjes, etj. Në këtë monitorim nuk është përfshirë e gjithë kronika e zezë në këto botime, por vetëm ata artikuj që prekin tema të lidhura me krimin e organizuar, domethënë jo krimet që janë episode të vecuara, krime pasionale apo në familje, krimet e rëndomta, etj.

❖ Monitorimi sasior i artikujve

Gjatë periudhës së monitorimit, domethënë në periudhën janar-mars 2005, u monitoruan gjithsej 633 artikuj të botuar në lidhje me krimin e organizuar në shtatë gazetë e sipërpërmendura. U vu re se këta artikuj zinin një hapësirë të konsiderueshme në gazetë, duke u bërë një nga temat më të rëndësishme. Artikujt varionin nga shkrime prej dy paragrafesh, në formë njoftimi, në artikuj më të zgjeruar dhe më rrallë intervista relativisht të gjata. Nuk ishin të rralla rastet kur një temë zinte një deri në dy faqe gazete në një numër, tregues i rëndësisë së pasqyrimin të saj. Kjo ka ndodhur më shumë në rastin e vrasjeve të bujshme, si ishte procesi kundër “Hakmarrje për drejtësi,” atentati ndaj Vajdin Lamaj, shpërthimi në rrugën Don Bosko në mars të këtij viti, etj.

Për arsye të lehtësimit të monitorimit, këto artikuj u monitoruan në këto kategori, në lidhje me temën që pasqyronin: trafiku i drogës dhe trafikimi i qenieve njerëzore, i ndarë në nënkategori si trafikimi i të miturve, i femrave, dhe i klandestinëve. Gjatë gjithë periudhës së monitorimit janë vërejtur 185 artikuj për trafikun e drogës dhe 140 për trafikimin e qenieve njerëzore, përkatësisht 30 për trafikimin e të miturve, 65 për trafikimin e femrave dhe 45 për trafikimin e klandestinëve.

Dy kategori të tjera kishin të bënin me krimin e organizuar por për rëndësinë që kishin si çështje dhe si pasqyrim në gazeta u trajtuan si kategori të vecanta. Në këtë kategori u përfshinë çështja e ashtuquajtur “Hakmarrje për drejtësi” dhe çështja e atentatit ndaj Vajdin Lamaj. Këto tema kanë pasur një pasqyrim përgjithësisht të detajuar dhe rekord për nga ana sasimore, me përkatësisht 87 artikuj për “Hakmarrja për drejtësi” dhe 80 artikuj për atentatin ndaj Vajdin Lamaj.

Kategoria e fundit kishte të bënte me çështje të tjera që ishin të lidhura me krimin e organizuar, ose dyshoheshin si të tilla, por të cilat ishin të pakta në numër për t’u përfshirë më vete, si për shembull trafiku i armëve, shpërthimi i ndodhur në mars te rruga Don Bosko, etj. Gjithashtu, në këtë kategori të fundit janë përfshirë edhe shkrime të karakterit të përgjithshëm, si për shembull veprimtaria policore e shtetit në vija të përgjithshme, konferencat ku kanë marrë pjesë autoritetet shtetërore, deklaratat e përgjithshme zyrtare, etj. Gjithsej në këtë kategori janë numëruar 142 artikuj me tema të ndryshme.

Për hir të kuptimit të drejtë të monitorimit dhe përzgjedhjeve të bëra duhet sqaruar se ka pasur artikuj që mbulonin më tepër se një temë, për shembull një grup kriminal që mund të merrej dhe me trafikimin e qenieve njerëzore dhe me trafikun e drogës. Për lehtësi studimi u vendos që të përzgjidhet tema mbizotëruese. Në raste kur ka qenë e pamundur të bëhet dicka e tillë, atëherë artikulli është klasifikuar në kategorinë e përgjithshme.

Tabelat e mëposhtme japin me detaje pasqyrimin sasior të artikujve për cdo muaj, në bazë gazete dhe teme. Gjithashtu përfshihet dhe pasqyrimi tërësor i të gjithë artikujve në periudhën janar-mars 2005:

➤ **Pasqyrimi sasior i krimit të organizuar në periudhën janar-mars 2005**

| <i>Temat kryesore per gazete</i> | <i>Gazeta Shqiptare</i> | <i>Panorama</i> | <i>Korrieri</i> | <i>Shekulli</i> | <i>Metropol</i> | <i>Koha Jone</i> | <i>Tema</i> | Total |
|--------------------------------------|-------------------------|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|------------------|-------------|--------------|
| <i>Trafiku i droges</i> | 28 | 24 | 24 | 25 | 34 | 23 | 27 | 185 |
| <i>Trafikimi i qenieve njerezore</i> | 28 | 18 | 21 | 20 | 22 | 12 | 19 | 140 |
| <i>- te mitur</i> | 6 | 3 | 2 | 6 | 6 | 4 | 3 | 30 |
| <i>- femra</i> | 12 | 10 | 12 | 7 | 12 | 3 | 9 | 65 |
| <i>- klandestine</i> | 10 | 5 | 7 | 7 | 4 | 5 | 7 | 45 |
| <i>Hakmarrje per drejtesi</i> | 15 | 9 | 16 | 13 | 12 | 9 | 13 | 87 |
| <i>Atentati ndaj Vajdin Lamaj</i> | 16 | 10 | 14 | 7 | 9 | 3 | 21 | 80 |
| <i>Te tjera dhe te pergjithshme</i> | 19 | 19 | 25 | 22 | 18 | 9 | 30 | 142 |
| Total | 106 | 80 | 99 | 87 | 95 | 56 | 110 | 633 |

➤ **Pasqyrimi sasior i krimit të organizuar gjatë muajit janar 2005**

| <i>Temat kryesore per gazete</i> | <i>Gazeta Shqiptare</i> | <i>Panorama</i> | <i>Korrieri</i> | <i>Shekulli</i> | <i>Metropol</i> | <i>Koha Jone</i> | <i>Tema</i> | Total |
|--------------------------------------|-------------------------|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|------------------|-------------|--------------|
| <i>Trafiku i droges</i> | 16 | 7 | 11 | 8 | 11 | 9 | 10 | 72 |
| <i>Trafikimi i qenieve njerezore</i> | 11 | 8 | 5 | 10 | 11 | 5 | 6 | 56 |
| <i>- te mitur</i> | 2 | 0 | 0 | 3 | 4 | 1 | 0 | 10 |
| <i>- femra</i> | 5 | 6 | 4 | 4 | 4 | 2 | 3 | 28 |
| <i>- klandestine</i> | 4 | 2 | 1 | 3 | 3 | 2 | 3 | 18 |
| <i>Hakmarrje per drejtesi</i> | 4 | 4 | 3 | 4 | 2 | 2 | 3 | 22 |
| <i>Te tjera dhe te pergjithshme</i> | 5 | 4 | 8 | 6 | 2 | 6 | 5 | 36 |
| Total | 36 | 23 | 27 | 28 | 26 | 22 | 24 | 186 |

➤ **Pasqyrimi sasior i krimit të organizuar gjatë muajit shkurt 2005**

| <i>Temat kryesore per gazete</i> | <i>Gazeta Shqiptare</i> | <i>Panorama</i> | <i>Korrieri</i> | <i>Shekulli</i> | <i>Metropol</i> | <i>Koha Jone</i> | <i>Tema</i> | Total |
|--------------------------------------|-------------------------|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|------------------|-------------|--------------|
| <i>Trafiku i droges</i> | 6 | 7 | 5 | 5 | 12 | 4 | 6 | 45 |
| <i>Trafikimi i qenieve njerezore</i> | 3 | 0 | 8 | 7 | 3 | 3 | 3 | 27 |
| <i>- te mitur</i> | 1 | 0 | 1 | 1 | 0 | 1 | 1 | 5 |
| <i>- femra</i> | 2 | 0 | 6 | 3 | 3 | 0 | 1 | 15 |
| <i>- klandestine</i> | 0 | 0 | 1 | 3 | 0 | 2 | 1 | 7 |
| <i>Hakmarrje per drejtesi</i> | 5 | 2 | 5 | 3 | 4 | 2 | 3 | 24 |
| <i>Te tjera dhe te pergjithshme</i> | 2 | 6 | 5 | 3 | 4 | 0 | 1 | 21 |
| Total | 16 | 15 | 23 | 18 | 23 | 9 | 13 | 117 |

➤ **Pasqyrimi sasior i krimit të organizuar gjatë muajit mars 2005**

| <i>Temat kryesore per gazete</i> | <i>Gazeta Shqiptare</i> | <i>Panorama</i> | <i>Korrieri</i> | <i>Shekulli</i> | <i>Metropol</i> | <i>Koha Jone</i> | <i>Tema</i> | Total |
|--------------------------------------|-------------------------|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|------------------|-------------|--------------|
| <i>Trafiku i droges</i> | 6 | 10 | 8 | 12 | 11 | 10 | 11 | 68 |
| <i>Trafikimi i qenieve njerezore</i> | 14 | 10 | 7 | 3 | 8 | 4 | 10 | 56 |
| <i>- te mitur</i> | 3 | 3 | 1 | 2 | 2 | 2 | 2 | 15 |
| <i>- femra</i> | 5 | 4 | 2 | - | 5 | 1 | 5 | 22 |
| <i>- klandestine</i> | 6 | 3 | 5 | 1 | 1 | 1 | 3 | 20 |
| <i>Hakmarrje per drejtesi</i> | 6 | 3 | 8 | 6 | 6 | 5 | 7 | 41 |
| <i>Atentati ndaj Vajdin Lamaj</i> | 16 | 10 | 14 | 7 | 9 | 3 | 21 | 80 |
| <i>Te tjera dhe te pergjithshme</i> | 12 | 9 | 12 | 13 | 12 | 3 | 24 | 85 |
| Total | 54 | 42 | 49 | 41 | 46 | 25 | 73 | 330 |

❖ **Monitorimi cilësor i artikujve**

Monitorimi cilësor i artikujve u përqëndrua në aspektet më të rëndësishëm dhe tiparet kryesive të përmbajtjes së artikujve të monitoruar, si dhe në paraqitjen e tyre. Një nga aspektet më të rëndësishme ishte burimi i informacionit, cilësimi i tyre, si dhe marrëdhëniet e gazetarëve me personat e implikuar apo me autoritetet zyrtare. Paraqitja grafike e artikujve, karakteri i krimit të organizuar, terminologjia e përdorur si dhe kufiri ndarës midis faktit dhe akuzës ishin aspekte të tjera të përmbajtjes që u analizuan.

1. Burimet e informacionit

Gjatë monitorimit të artikujve në lidhje me krimin e organizuar ajo që të bie në sy përse u përket burimeve të informacionit është mbizotërimi i padiskutueshëm i burimeve zyrtare për informacion, si janë Ministria e Rendit, përfaqësues të policisë së shtetit në të gjitha nivelet, prokuroria, gjykatat, etj. Ky rezultat është mëse i pritshëm dhe i natyrshëm duke pasur parasysh që këto segmente janë ato që përballen dhe trajtojnë këtë temë dita ditës. Për rrjedhim, është pikërisht citimi i këtyre burimeve që nuk duhet të mungojë në artikujt për krimin e organizuar, përndryshe informacioni nuk do të ishte i besueshëm.

Megjithatë, ky aspekt i rëndësishëm i artikujve mbi krimin e organizuar duhet parë në të gjitha tiparet e tij, në mënyrë që të kemi një ide më të plotë rreth pasqyrit të kësaj teme. Për këtë arsye, monitorimi i burimeve të informacionit është parë në dy këndvështrime, gazetaret dhe burimet zyrtare nga njëra anë, dhe gazetaret dhe subjektet e tyre, pra njerëzit e prekur, nga ana tjetër. Një përzgjedhje e tillë u bë për arsye se të dyja këto aspekte ngrenë pikëpyetje të rëndësishme etike, vecanërisht në gazetarinë që mbulon krimin, por edhe në të gjitha llojet e gazetarisë në përgjithësi.

Marrëdhënia e gazetarëve me burimet zyrtare

- Cilësimi i burimeve

Megjithëse është një rezultat i pritshëm që burimet zyrtare të jenë baza e artikujve mbi krimin e organizuar, ajo që nuk është dhe aq e kuptueshme është mënyra se si ato citohen në shumë raste. Ndodh shumë shpesh që nuk jepet emri dhe pozicioni i burimit zyrtar, por fraza të mjegullta të llojit “sipas hetimeve,” “grupi hetues thotë,” “burime konfidenciale shprehen se,” “policia bën të ditur se,” “sipas burimeve nga prokuroria,” etj.

Ky formulim përgjithësues i burimeve të informacionit duket se është i pajustificueshëm në momente që në të shumtën e rasteve ky informacion duket se është marrë në konferenca shtypi, komunikata shtypi të organeve të policisë, vendime gjyqi, etj, pra në rrethana tërësisht publike. Atëherë nuk ka arsye që të mos cilësohen me emër dhe pozicion zyrtar këto burime. Ky veprim sado i vogël që është, me pak mundim, vetëm do të shtonte besueshmërinë e informacionit dhe do minimizonte mundësitë për padi gjyqësore.

Në këtë aspekt është e drejtë që të merren parasysh edhe rastet kur informacioni nuk është publik dhe i jepet në konfidencë gazetarëve. Në këto raste veprimi më normal do të ishte që burimi të mos citohej me emër dhe pozicion, por të cilësohej që ai kishte folur në kushte anonimati. Në këtë mënyrë, do të zbutej disi pozita e citimit të burimeve të paidentifikuara, që janë mbizotëruese në këto shkrime.

- *Balancimi i burimeve*

Një nga parimet kryesore të gazetarisë është konfirmimi i informacionit nga të paktën dy burime. Në rastin tonë duhet vënë re që në shumicën dërrmuese të rasteve burimet zyrtare janë të vetmet burime, pra gazetarët varen vetëm nga fjala e tyre për t'i përcjellë publikut atë cka ndodh në këtë fushë. Nuk diskutohet që ekzistojnë përpjekje për të marre informacion edhe nga burime të tjera, si për shembull intervista nga të akuzuarit apo nga të afërmit e tyre, nga dëshmitarë, apo nga ekspertë të ndryshëm. Megjithatë, këto janë përpjekje mjaft të kufizuara dhe jo gjithnjë bëhet kujdes që ato të mos shndërrohen në informacion të panevojshëm, banal, ose që prek të lënduarit në momente të vështira.

Gjatë këtij monitorimi u vërejt se në më të shumtën e rasteve burimi i dytë i shkrimit ishte një intervistë me të afërm të të pandehurve ose viktimave, dhe shumë më rrallë intervistë me vetë të pandehurit. Për shembull, shumë gazeta arritën që pas kalimit në arrest shtëpie të Imelda Tashos, të akuzuarës për bashkëpunim në vrasjen e Genci Sinës, të merrnin një intervistë me telefon nga ajo. Po ashtu mund të përmendet dhe rasti kur u arrestuan tre të rinj të dyshuar për pjesmarrje në bandën e Lushnjës. Familjarët paraqitën variantin e tyre për ngjarjen edhe në këtë rast:

“Kam mbetur i zhgënjyer. Djali im punon në lokalin që kemi me qera, nga ora 05.00 deri në 22.00, dhe një njeri që punon nuk ka kohë dhe mendje të merret me pislleqe. Për mua agjentët duhej të pyesnin më parë për të dhe familjen time dhe vetëm kur të siguroheshin të vepronin. Një kriminel i atij kalibri që pretendohet nuk jeton në atë shtëpi me qera ku jam unë dhe im bir.”

[“Agjentja futi në kurth bandën,” *Gazeta Shqiptare*, 19 mars 2005, f.11.]

Megjithëse argumentat e dhëna nga familjari janë padyshim të diskutueshme, fakti që edhe ato jepen në shkrim shton vlerën e shkrimit si dhe ndershmërinë dhe drejtësinë ndaj të pandehurve dhe familjarëve. Megjithatë duhet theksuar që këto raste mbeten ende të pakta në numër dhe të pamjaftueshme ose të parëndësishme si informacion, ndoshta edhe për arsye të vështirësisë së marrjes së informacionit nga këto burime.

- *Marrëdhëniet publike dhe gazetarët*

Marrëdhënia e ndërsjellë midis gazetarëve dhe burimeve zyrtare të informacionit mbi krimin e organizuar nuk duket se transmetohet e qartë në artikuj. Nga mënyra e paraqitjes së informacionit duket se gazetarët shpesh janë vetëm transmetuesit e fjalëve të burimeve. Rrallë ndodh që të ketë një vënie në pikëpyetje e këtij informacioni apo sqarimi të mëtejshëm. E njëjta gjë vlen edhe për ato pak raste kur merret dhe mendimi i palës tjetër, për shembull të pandehurit ose të afërmit e tyre. Ajo që mungon në këta artikuj është një vështrim më analitik i këtyre informacioneve dhe qëndrimeve. Ato vetëm sa transmetohen nga një artikull në tjetrin, derisa çështja të mos përbëjë më lajm.

Për hir të gazetarëve dhe punës së tyre duhet përmendur dhe varësia e tyre nga hallka të tilla si të gjitha hapat e procedurave ligjore në kësi rastesh, që nga ndalimi i një personi, arrestimi, ngritja e padisë, çështja gjyqësore në të gjitha nivelet e mundshme, etj. Gjatë gjithë këtyre hallkave gazetarët janë të lidhur ngushtë me zëdhënësëat apo figura të tjera të policisë, prokurorisë, gjykatave. Si e tillë, kjo marrëdhënie shpesh i shndërron gazetarët dhe artikujt e tyre në hapësira të lira ku pala tjetër mund të shprehë fare mirë pozicionin e saj. Në këtë mënyrë, shpesh bëhet shumë e vështirë të dallosh se ku mbarojnë marrëdhëniet publike dhe ku fillon pasqyrimi me karakter informativ për publikun.

Më konkretisht, gjatë monitorimit ka pasur mjaft raste kur artikujt dukej se ishin shkruar vetë nga dora e zëdhënësit të organeve shtetërore dhe jo nga gazetari, ose që kishin informacion që i shkonte mjaft për shtat përmirësimit të imazhit të këtyre organeve. Për shembull, citohen shpesh burime zyrtare në deklarata të përgjithshme të bëra në seminare, trajnime, apo takime për të cilat publiku mund të mos jetë nevojta të ketë kaq informacion të detajuar:

“Për të përshëndetur në këtë takim ishte edhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Ai tha se: ‘Shqipëria është në rrugën e saj drejt integritit për në Bashkimin Europian. Për ne si shqiptarë është mjaft e qartë se na duhet shumë rrugë dhe shumë përpjekje për të bërë që të pranohe mi në BE.’”

[“BE trajnon policinë shqiptare për sigurinë kufitare,” *Tema*, 9 mars 2005, f.5]

Apo:

“Në fakt, bashkëpunimi mes ekspertëve ndërkombëtarë dhe atyre shqiptarë mbështetet në një sërë marrëveshesh të lidhura me këto organizma të rëndësishëm. Kështu në deklaratën e përbashkët të 14 majit të kaluar në Bukuresht, mes ministrive të Rendit të vendeve të Evropës Juglindore, (SEECp), sanksionohet orientimi që të ndërmerren hetime të përbashkëta më proaktive, për t’iu kundërvënë krimit në vendet nënshkruese, një prej të cilave është edhe Shqipëria. Burimet e Ministrisë së Rendit pohuan se këto organizma të specializuara kanë patur më parë një minision më të avancuar në hetimet e ngjarjeve të ndryshme që kanë ndodhur në Shqipëri.”

[“Ekspertë të huaj për vrasjen e Lames,” *Korrieri*, 4 mars 2005, f.7.]

Gazetarët dhe subjektet e tyre

Një konsideratë shumë e rëndësishme etike që gazetarët e krimit të organizuar duhet të kenë parasysh është marrëdhënia që vendosin ata me njerëzit e prekur nga raportimi, pra të pandehurit, viktimat, të dyshuarit, të afërmit e tyre, etj. Zgjedhja e vështirë midis informacionit që publiku duhet të dijë dhe të drejtës për jetë private dhe mosçenim të dinjitetit të personave privatë dhe publikë është barra që bie mbi supet e gazetarit. Megjithëse nuk jetojmë në kushte ideale ku kjo zgjedhje do të varej vetëm nga gazetari, përsëri këto janë konsiderata që normalisht gazetari do i kishte në mendje.

Ajo që vihet re në këta artikuj është se në përgjithësi ka një përmirësim të ndjeshëm të mbulimit të njerëzve të prekur nga këto tema dhe nuk abuzohet ndjeshëm me terma ofenduese apo stereotipe. Pavarësisht nga kjo, këto dukuri nuk janë zhdukur aspak, ato shfaqen herë pas here, megjithëse jo aq shpesh dhe në formë aq bruto sa disa vite më parë. Një tendencë shqetësuese e disa gazetave është ajo e ndërhyrjes në jetën private deri në hollësi banale që s’paraqesin asnjë interes për të drejtën e publikut për të pasur informacion.

Një rast i tillë mund të citohet në një artikull të shkruar pasi Imelda Tasho, një nga të pandehurat për vrasjen e shoferit të prokurorit të përgjithshëm, kalon në arrest shtëpie. Përveç artikullit të zgjeruar që detajon vendimin e gjykatës, në një gazetë u përshkrua me detaje edhe vajtja e Tashos në shtëpi. Detajet ishin të llojit të mëposhtëm:

“Shtëpia shndriste dhe kuptohej se menjëherë pas vendimit të gjykatës aty kishin filluar përgatitjet për pritjen e vajzës, aq të rëndësishme, sikur të bëhej fjalë për një gosti të përmasave jo të zakonta.”

“Lotë dhe përqaftime nga sapo e liruar dhe gratë e shumta.”

“Këto ishin fjalët e inspektorit të policisë, i cili i ndërpreu një cast vajzës hovin e marrë për të kapërcyer pragun e shtëpisë. ‘Ju do qëndroni këtu, nga jashtë derës. Do ndërroheni me ata të turnit tjetër,’ iu drejtua më pas inspektori dy prej katër policëve, të cilët edhe ata po përtypnin karamelet e shpërndara nga nëna e Imeldës.”

[“Imelda pritet si princeshë në shtëpi: Banesa rregullohet si për festë, qerasje dhe urime,” *Gazeta Shqiptare*, 8 janar 2005, f.9.]

P.sh. ka raste kur kjo bëhet me qëllim ndoshta edhe për t’i dhënë një fytyrë njerëzore të pandehurve, ose ata për të cilët është dëgjuar vetëm deklarata zyrtare e organeve shtetërore. Por si në të gjitha çështjet etike, edhe në këto raste është shumë e lehtë të kapërcesh nga qëllimi i mirë në informacion tërësisht të kotë dhe madje edhe në kufi të thashethemeve rozë.

Fatkeqësisht paraqiten dhe raste të tjera kur detajet e dhëna janë shumë më të rënda dhe përshkruajnë në mënyrë grafike një krim të ndodhur apo të supozuar. Mbetet gjithnjë një pyetje me vlerë të madhe etike nëse ia vlen të botohet ky informacion apo jo, dhe nëse po, çfarë forme duhet të ketë ai që t’i shërbejë sa më mirë publikut.

Më konkretisht, gjatë monitorimit u vunë re disa raste kur detajet ishin mjaft të gjalla dhe të rënda:

“Motra e saj Suzana ka treguar para gjykatës së Gjenovës sesi e kishin bërë të abortonte. ‘Bërtisja e terrorizuar, se e dija që abortin do e bëja te ndonjë cigane. Një vajzë e re hipi si kalë mbi barkun tim, ndërsa mori dy shufra hekuri nga një raft dhe ia dha një të vjetre. Ajo pa hezituar i futi me forcë në vaginën time dhe i shtynte me forcë sa më lart. Pastaj nuk mbaj mend gjë, sepse kam kaluar në gjendje të fikti.”

[“Viktima e bandës: Ja si më detyruan të abortoja te ciganet e rrugës,” *Gazeta Shqiptare*, 5 mars 2005, f.11.]

Pavarësisht se këto rrëfime duket se vijnë nga salla e gjyqit dhe japin idenë e shkallës së rëndë të veprës penale, përsëri është e diskutueshme nëse këto detaje duhen botuar apo jo, si për hir të publikut, ashtu edhe për hir të dëshmitares, aq më tepër në një rast të tillë, kur ajo është identifikuar me emër.

Apo:

“Por gruaja shqiptare dy vjet më parë kishte humbur djalin e saj në një mënyrë shumë të tmerrshme, pasi ia kishin ndarë mishin në copa dhe më pas ia kishin futur në një copë plastmasi.”

[“Pranga shqiptares 45-vjecare, pjesëtare e trafikut të drogës,” *Gazeta Shqiptare*, 19 janar 2005, f.11]

Në këtë rast bëhet fjalë për një grua të implikuar në trafikun e drogës dhe nuk duket se ka ndonjë rëndësi të vecantë vdekja e birit të saj para dy vjetësh për ngjarjen, ose të paktën, duket se janë krejtësisht të tepërta dhe pa vend detajet e vdekjes së tij.

Një aspekt tjetër mjaft i rëndësishëm i marrëdhënies mes gazetarëve dhe njerëzve të prekur apo të hetuar apo dyshuar është dhe identifikimi i këtyre të fundit apo terminologjia e përdorur gjatë raportimit. Pavarësisht se mund të duket një çështje jo dhe aq e rëndësishme, identifikimi dhe

terminologjia e përdorur, përveçse të çënojnë dinjitetin e personit, mund të bëhen edhe shkas për padi gjyqësore. Si të tilla, ky aspekt duhet trajtuar me kujdesin e duhur.

Në përgjithësi mund të thuhet që gazetatat e kanë respektuar terminologjinë korrekte të kësaj teme, duke shkuar krah më krah me hallkat e ndryshme të procesit gjyqësor. Kështu, nuk ka pasur raste kur i ndaluarit të jetë quajtur i akuzuar, apo i akuzuari vrasës. Rastet më të shpeshta të pakorrektesisë në këtë aspekt kanë qenë ato të përdorimit të termit “prostitutë,” ndërkohë që në shumicën e rasteve, si del dhe nga informacioni i mëtejshëm, kemi të bëjme me viktima.

Megjithëse është përdorur një gjuhë e kujdesshme në shumicën e rasteve, ka ende pasaktësi, insinuacione, aludime, apo terma që nuk i shkojnë për shtat profesionit të gazetarit:

“Pas këtyre akuzave, Ministria e Brendshme greke ka grumbulluar materiale në një dosje të vecantë për veprimtarinë çnjerëzore të Vavilisit.”

[“Vavilis, akuza për trafik organesh e droge,” *Koha Jonë*, 31 mars 2005, f.3]

Fjala “çnjerëzore” në këtë rast është e tepërt, edhe pasi janë dhënë akuzat për Vavilis, pasi nuk i takon gazetës të gjykojë për këtë veprimtari pa u verifikuar ende nëse akuzat janë të vërteta.

“Tashmë është bërë e modës që personat e ndaluar.... refuzojnë të flasin ose të marrin vetë përsipër autorësinë e trafikimit dhe pronësinë e lëndës narkotike. Burime nga Prokuroria e Krimeve të Rënda kanë sqaruar se një metodë e tillë nuk bëhet se të implikuarit shpresojnë se do t’ia hedhin, por bëhet vetëm për t’i dhënë mundësi bashkëpunëtorëve të tjerë që të largohen ose të fshihen.”

[“Të ndaluarit mohojnë pronësinë e drogës,” *Gazeta Shqiptare*, 11 janar 2005, f.9]

Në këtë rast, duken të tepruara fraza të tilla si “është bërë e modës” ndërkohe që flitet për krime, apo përgjithësime të tipit të mësipërm, aq më tepër kur vijnë nga burime pa emër. Këto i japin shkrimin më tepër një atmosferë llafesh korridoresh sesa një raportim serioz e bindës, në një kohë që shkrimi mund të ketë qenë shumë më i mirë pa këto terma apo përgjithësime.

2. Paraqitja grafike

Edhe pse paraqitja grafike (fotot, faqosja, vizatimet, etj) janë zgjedhje individuale të gazetave dhe bëhen në kuadër të gjithë botimit, përsëri zgjedhjet që bëhen shpesh ndihmojnë ose vështirësojnë dhënien e informacionit te publiku. Është për t’u theksuar se në këtë drejtim gazetatat kanë një përparim të dukshëm.

Në shumicën e rasteve artikulli organizohet i faqosur me artikullin kryesor, kuti me informacion plotësues, skeda biografike të personazheve, kronologji të ngjarjeve, informacion dhe detaje plotësuese, grafikë, tabela apo harta, të gjitha këto të paketuara qartë dhe në funksion të plotësimit dhe lehtësimit të dhënies së informacionit. Gjithashtu, ky informacion në pothuaj të gjitha rastet përfshin informacion sqarues për çështje që vazhdojnë prej kohësh, duke përfshirë kronologjinë e ngjarjes. Të gjitha këto detaje patjetër që ndihmojnë lexuesin të përqendrohet në atë informacion që i intereson ose që ta sistemojë më mirë atë. Nëse kjo paraqitje është ndonjëherë e ngarkuar grafikisht mbetet një diskutim tejet profesional, por fakti mbetet se gazetatat në këtë aspekt kanë një sukses të ndjeshëm.

Atje ku gazetatat duket se nuk kanë pasur ndonjë sukses të vecantë janë fotot. Ndoshta edhe për vetë temën që paraqisin, si dhe për arsye të tjera si mungesa e burimeve financiare, mungesa e

fotogazetarisë, etj, fotot janë jashtëzakonisht të thata, shpesh edhe foto të dokumentit të identifikimit ose në momentin e arrestimit. Gjithashtu, vërehet një përdorim i shpeshtë i fotove të arkivit, dhe shumë rrallë këto foto identifikohen si të tilla. Redaksitë mendojnë se është më e rëndësishme që artikulli të shoqërohet me një ilustrim sesa të identifikohet lidhja e këtij ilustrimi me informacionin. Ndonjëherë ndodh që këto foto të kenë edhe pamje të censurueshme, pasi paraqesin të mitur, skena lakuriqësie dhe dhune, etj, dhe mbetet një diskutim etik mjaft i vlefshëm nëse ato duhen botuar fare të pacensuruara apo nuk duhen botuar. Gjithsesi, mund të thuhet me plot gojë që fotot e arkivit duhen dalluar nga ato të vërtetat. Duhet shtuar se rastet kur përdoren dicitura për fotot, me përjashtim të emrave të personave, janë tejet të rralla. Të gjitha këto tipare të përdorimit të fotove tregojnë se gazetave u mbetet mjaft punë për të bërë në këtë drejtim.

3. Karakteri ndërkombëtar i krimit

Ndërkohë që krimi i organizuar ka marrë në rritje një karakter transnacional, mbulimi që i bëhet atij në media shpesh merr trajtën e përkufizimit etnik. Vihet re një tendencë e theksuar për të identifikuar personat apo organizatat në bazë të kombësisë së tyre dhe ndonjëherë ky identifikim është aq i fortë sa anashkalohet fakti që karakteri i krimit të organizuar ka lënë pas cdo lloj identifikimi kombëtar. Kështu për shembull nuk janë të rrallë titujt si “Itali, policia godet bandën cigano-shqiptare,” “Pranga shqiptares 45-vjecare, pjesëtare e trafikut të drogës,” “Burg shqiptarëve të shtëpisë publike,” “Të huaj në atentatin ndaj Lamajt” apo “Italiani i penduar: Isha korrier i drogës.”

Ndërkohë që identifikimi kombëtar, edhe pse i theksuar, ka raste që shërben për të dhënë më shumë informacion për personat e implikuar, duket se ky identitet është mjaft i rëndësishëm dhe vihet në dukje gjithë kohën edhe nga autoritetet, si ato të huaj, ashtu edhe shqiptare.

“Policia italiane thotë se nga mënyra e vrasjes së vajzës, dyshohet që autorët të jenë shqiptarë. Sipas policisë, mbi vajzën është ushtruar shumë dhunë, e cila është karakteristike e grupeve shqiptare që kontrollojnë tregun e prostitucionit.”

[“Masakrohet në Itali një 20 vjecare shqiptare,” *Tema*, 12 janar 2005, f.6]

Këto lloj prononcimesh janë të shpeshta edhe nga pala shqiptare. Në rastin e cituar më poshtë krahasohen dy atentatet e bëra ndaj Vajdin Lamaj dhe baza e shpjegimit është kombësia:

“Sipas hetuesit, dy tentativat janë shumë larg njëra-tjetrës, përse i përket sofistikut të realizimit dhe lënies së provave. ‘Në rastin e parë është një atentat i rëndomtë ala-shqiptarësh, të cilët jo vetëm që nuk mundën të realizonin qëllimin e tyre, por nuk u treguan as të kujdesshëm, duke lënë shumë gjurmë në vendngjarje. Ndërsa në rastin e dytë nuk ka të ngjarë që dora të ketë qenë e njëjtë. Madje besojmë se nuk është dorë shqiptarësh’, pohoi i bindur hetuesi.”

[“Të huaj në atentatin ndaj Lamajt,” *Gazeta shqiptare*, 5 mars 2005, f.9]

Në të dyja këto raste vihet re një paragjykim i fuqishëm ndaj kombësisë dhe mënyrës sesi ajo mund të shfaqet në anë të tilla të errëta si krimi. Supozimi që vihet re është se kombësia përcakton dhe shkallën e dhunës apo mencurinë e krimit. Deklarata të tilla paraqesin patjetër rrezik, sepse propozojnë stereotipe të caktuara, kryesisht negative, ose forcojnë stereotipet ekzistuese. Si të tilla, duhet bërë mjaft kujdes në gjuhën dhe terminologjinë e përdorur.

Përvec stereotipeve që përhapen në këtë mënyrë, kjo lloj gjuhe lë në hije edhe një nga tiparet thelbësore të krimit të organizuar për momentin: karakterin e tij ndërkombëtar. Ose në rastin më të

mirë, nuk lejon thellimin e mëtejshëm të informacionit në lidhje me këtë fenomen. Sigurisht, arsye më të rëndësishme të kësaj gjendjeje janë edhe mungesa e një tradite të gazetarisë investigative si dhe burimet e kufizuara financiare për ta zhvilluar një traditë të tillë deri më sot. Gjithsesi, mbetet i qartë fakti që në një periudhë kur strukturat e krimit të organizuar janë shembull i përzierjes etnike, në shtyp identifikimi kombëtar ende ka një rol mjaft të dukshëm.

4. Kufiri mes informacionit dhe gjykimit

Duhet theksuar që është e dukshme përjekja për t'iu përmbajtur fakteve në shtypin e përditshëm në lidhje me raportimin e krimit të organizuar. Megjithatë, ka pasur edhe raste kur është shkelur vija ndarëse mes dhënies së informacionit dhe dhënies së gjykimit. Në disa raste ka qenë çështje terminologjie:

“Mësohet se vajza nuk është keqtrajtuar nga autorët e këtij akti të shëmtuar, por ajo ka qenë e detyruar të pozojë nudo për vëllezërit Sanco për disa minuta.”

[“Shpëtohet nga trafikimi 14-vjecarja, pesë në pranga,” *Panorama*, 22 janar 2005, f.16]

Edhe pse pothuajse të gjithë lexuesit do binin dakord që akti ishte i shëmtuar, përsëri ky është një përfundim që duhet lënë në dorë të lexuesit. Nuk është me vend që gazetari të japë gjykimin, roli i tij në këtë lloj artikulli është vetëm dhënia e fakteve.

Gjithashtu duhen shmangur edhe përfundimet e nxituara, të cilat i vënë gazetarët në rolin e autoriteteve hetuese:

“Shenjat e gishtave pikërisht në pakot e hashashit e rëndojnë së tepërmi pozitën e tij dhe nga ana tjetër janë një provë mjaft e fortë për Prokurorinë e Krimeve të Rënda në vërtetimin e akuzës. Kjo provë bëhet edhe më e vlefshme në kushtet kur të ndaluarit mohojnë plotësisht akuzat e ngritura ndaj tyre.”

[“Hashashi i Vlorës, kapet i gjashti,” *Gazeta shqiptare*, 13 janar 2005, f.12]

Kjo deklaratë është pjesërisht dhënie informacioni që publiku duhet të ketë. Por informacioni i vlershëm mbaron atëherë kur gazetari fillon jep mendime për vlershmërinë e provave, aq më tepër kur kjo bëhet duke pasur parasysh mohimin e të pandehurve, gjë që tregon dhe një lloj paragjykimi ndaj tyre.

❖ **Krimi i organizuar dhe liria e shtypit**

Një aspekt mjaft i rëndësishëm që duhet konsideruar në lidhje me raportimin e krimit të organizuar është liria që kanë gazetarët për të raportuar mbi këtë temë, pasi ky është një faktor që ndikon tej mase në cilësinë e raportimit. Duke pasur parasysh që pasqyrimi i krimit të organizuar është një nga temat më të ndjeshme dhe si e tillë edhe një fushë e minuar për gazetarët dhe shtypin në përgjithësi, pjesë e projektit ishte testimi i lirisë së shtypit në këtë fushë. Në këtë kuadër, u intervistuan 10 gazetarë nga 10 gazeta të përditshme. Gazetarët mbulonin sektorin e pasqyrimit të krimit në median ku punonin. Për këtë qëllim, u përgatit një pyetësor që rrekej të trajtonte pikat kryesore të punës së gazetarëve që pasqyrojnë krimin.

Kështu, pyetësoi trajtonte kryesisht aksesin në informacion dhe vështirësitë që duhet të kapërcejnë gazetarët në marrëdhënie me persona të ndryshëm, përdorimin e burimeve të informacionit dhe cilësimin e tyre, etj. Një aspekt i qenësishëm i pyetësorit ishte dhe marrëdhënia e gazetarëve me persona të mundshëm që mund të ushtrojnë presion ndaj tyre, si për shembull, autoritetet zyrtare, pronari, kryeredaktori apo redaktori i medias së tyre, individë të ndryshëm, etj.

Sipas intervistave me këta gazetarë, marrja e informacionit mbetet ende një sfidë që duhet përballuar. Edhe pse Shqipëria ka një ligj relativisht të mirë të aksesit në informacion, përsëri vështirësitë në zbatimin e tij mbeten për arsye të ndryshme dhe kjo reflektohet dhe në punën e gazetarëve. Kështu, pyetjes rreth vështirësisë së marrjes në informacion vetëm një nga gazetarët iu përgjigj negativisht. Ndërkohë nëntë të tjerët pohuan se kanë pasur vështirësi për informacionin dhe të nëntë thanë gjithashtu se autoritetet zyrtare përbënin vështirësi në këtë fushë.

Të pyetur nëse personat që jepnin me vështirësi informacion ishin autoritetet zyrtare, dëshmitarët, apo individë të ndryshëm, të parët u identifikuan nga nëntë të intervistuar, të dytët vetëm nga një, kurse të tretët nga tre të intervistuar. Duke pasur parasysh se burimet zyrtare janë baza e informacionit në këto raste, kjo përgjigje dhe të dhënat në përgjithësi nuk janë tregues aspak të mirë të zbatimit të ligjit për akses në informacion.

Si u vu re nga monitorimi, burimet pa emër përdorshin gjerësisht nga gazetarët, në shumë raste duke përbërë thelbin e gjithë shkrimit. Kështu, të intervistuarit u pyetën se sa shpesh përdorin burime informacioni pa emër. Vetëm një prej tyre u përgjigj “kurrë”, ndërkohë që tre thanë “rrallë”, katër “shpesh” dhe dy “zakonisht.” Edhe këto përgjigje janë një reflektim i rezultateve të monitorimit, më konkretisht, përhapja e gjerë e dhënies së informacionit nga burime pa emër ose të përgjithësuara në terma.

Një pjesë e rëndësishme e intervistës ishte liria e gazetarëve brenda redaksisë dhe jashtë saj. Kështu, pyetjet e bëra kishin lidhje me marrëdhëniet e tyre me pronarët dhe redaktorët e tyre nga njëra anë dhe me autoritete zyrtare dhe individë të tjerë nga ana tjetër. Këto intervista u bënë në anonimitet të plotë, për të siguruar praktikën e plotë dhe të pacensuruar të gazetarëve rreth lirisë së tyre.

Marrëdhëniet brenda redaksisë u konsideruan në prizmin e ndërhyrjes nga redaktorët apo pronarët në pranimin e botimit të shkrimeve, në ndërhyrjen e përmbajtjes së shkrimit, si dhe në caktimin e temave për të cilat duhet shkruar apo të atyre për të cilat ndalohet të shkruash. Sipas përvojës së të intervistuarve, atmosfera brenda redaksisë nuk është ideale për raportimin e krimit të organizuar, por gjithsesi është më e mirë se c’pritej para intervistave.

Kështu, nga 10 të intervistuar, vetëm tre thanë që u ka ndodhur që redaktori apo pronari të mos pranojë të botojë një shkrim për shkak të temës apo informacionit që mbart ai. Gjithashtu, vetëm dy pohuan se u kishte ndodhur që shkrimi i botuar të kishte përmbajtje të ndryshuar nga ai që ishte shkruar në fillim. Më tej, shumica dërrmuese, nëntë të intervistuar, thanë se u kishte ndodhur që redaktori apo pronari t'u thoshte se duhet të shkruanin për një temë të caktuar. Ndërkohë, vetëm dy pohuan se redaktori apo pronari u kishte thënë se nuk duhet të shkruanin për një temë të caktuar.

Një pyetje tjetër ishte nëse gazetarët kanë ndjerë presion në punën e tyre dhe nga cilat persona e kanë ndjerë këtë. Personat e përmendur ishin pronarët, redaktorët, autoritetet zyrtare dhe individët e ndryshëm. Nga kjo pyetje, gazetarët treguan për një mungesë totale presioni brenda redaksisë, pasi vetëm një gazetar tha se kishte ndjerë presion nga redaktori, ndërkohë që asnjë prej tyre nuk pranoi të kishte pasur presion nga pronari.

Situata ndryshonte ndjeshëm në lidhje me marrëdhëniet me autoritetet zyrtare dhe individët e ndryshëm. Katër nga 10 të intervistuar thanë se kishin ndjerë presion nga autoritetet zyrtare, ndërsa tetë prej tyre pohuan se kishin pasur presion nga individët e ndryshëm gjatë punës së tyre. Pyetjes se nga cilët persona u ndodhte të kishin më shpesh presion gjatë raportimit, gjashtë gazetarë iu përgjigjën nga individë të ndryshëm, ndërkohë që katër të tjerët pohuan se autoritetet zyrtare ishin këta persona.

Në përfundim, mund të thuhet se lajmi i mirë i këtyre intervistave ishte se gazetarët pohuan një atmosferë relativisht të qetë dhe të lirë brenda redaksisë, pa ndonjë presion të dukshëm në punën e tyre. Nga ana tjetër, nuk paraqitet mjaft e mirë gjendja për sa i përket marrëdhënieve me autoritetet zyrtarë dhe me individë të ndryshëm, ku nuk mungojnë presionet sipas gazetarëve. Gjithashtu, duket se duhen bërë përpjekje të mëtejshme për zbatimin më të mirë dhe të plotë të ligjit për akses në informacion, ose të përmirësimit të marrëdhënieve publike nga ana e autoriteteve zyrtare.

❖ Përfundimet

Në përfundim të këtij monitorimi mund të thuhet se është e vërtetë që raportimi për krimin e organizuar zë një hapësirë të konsiderueshme në gazetatat e përditshme kryesore në vend. Kjo është e vërtetë edhe kur ky pasqyrim krahasohet me temat e tjera që këto gazeta mbulojnë. Gjithashtu vihet re një pasqyrim përgjithësisht korrekt përse i përket gjuhës së përdorur në artikujt me temë pasqyrimin e krimit të organizuar.

Megjithatë nuk mund të thuhet që pasqyrimi i kësaj teme është i plotë. Shpesh raportimi është i lidhur ngushtë vetëm me ngjarjen, lajmin, dhe mbaron aty. Ndodh shumë rrallë që të vazhdojnë hetimet e pavarura apo të bëhet një raportim më i thellë. Kjo dukuri është një dëshmi e mungesës së një tradite të gazetarisë investigative, për arsye të rrezikut që ajo paraqet si dhe të burimeve financiare dhe njerëzore që kërkohen për zhvillimin e saj. Mund të thuhet me siguri që ky është një nga aspektet më të pazhvilluara në gazetarinë shqiptare.

Përdorimi i gjuhës dhe terminologjisë është gjithnjë një tipar që dëshmon cilësinë e raportimit dhe konceptin e gazetareve në marrëdhënie me të tjerët. Në këtë rast vihen re përmirësime të gjuhës dhe raportimit, megjithëse nuk mungojnë dhe rastet kur artikujt shfaqin detaje të panevojshme, banale, dhe lëndues për njerëzit e pasqyruar.

Përse i përket përmbajtjes së shkrimeve, vihet re një varësi totale e gazetareve nga burimet zyrtare në shkrimet e tyre, duke u nisur nga shpeshësia e citimeve të këtyre burimeve. Ekzistojnë edhe përpjekjet për të përfaqësuar palën tjetër, pra të pandehurit ose të arrestuarit, por zëri i tyre është mjaft i ulët në krahasim me burimet zyrtare.

Një tipar tjetër i theksuar i pasqyrimin të kësaj teme është edhe lidhja e ngushtë mes krimit dhe karakterit etnik. Ndërsa krimi i organizuar ka gjithnjë e më shumë një karakter transnacional, trajtimi që media i bën këtij fenomeni në shumicën e rasteve mbetet në korniza të ngushta nacionale. Ndërkohë tashmë është bërë e qartë që rrjetet e krimit të organizuar nuk mund të identifikohen duke u bazuar në ngjyra etnike.

Si përfundim, mund të thuhet në mënyrë të përmbledhur që raportimi i krimit të organizuar ka bërë përparime në lidhje me pasqyrimin korrekt, dhe pse jo gjithmonë të thellë të kësaj teme, por mbetet ende shumë për të bërë në kthimin e kësaj rryme në një gazetari të vërtetë investigative, për arsye të ndryshme, që jo gjithnjë varen nga gazetarët dhe formimi i tyre profesional.

❖ Rekomandime

Duke u nisur nga vëzhgimet e këtij monitorimi dhe duke pasur parasysh përfundimet që u nxorrën, u hartuan rekomandimet e mëposhtme për dy grupe kryesore, komunitetin e medias dhe institucionet shtetërore që kanë lidhje me pasqyrimin e kësaj teme:

Për komunitetin e medias:

- Të bëhet një kujdes më i madh me balancimin dhe identifikimin e burimeve, duke respektuar parimin e paanshmërisë.
- Të pakësohet përdorimi i burimeve të pacituara, ose të shprehet qartë që burimet nuk pranojnë të identifikohen.
- Të ruhet i qartë kufiri mes dhënies së informacionit dhe dhënies së gjyqimit.
- T'i kushtohet vëmendje e vecantë gjuhës së përdorur dhe terminologjisë.
- Kur është e mundur, të shkohet përtej lajmit dhe të bëhen raportime më të thellësishme ose panorama që vëzhgojnë një dukuri.
- Të kihet kujdes me identifikimin dhe trajtimin e të miturve dhe viktimat.
- Të zbutet identifikimi etnik i krimit, në mënyrë që të mos hiqet vëmendja nga karakteri ndërkombëtar i tij si dhe të mos krijohet mundësi për forcimin e stereotipeve.
- Të bëhet kujdes i vecantë me detajet dhe informacionin e dhënë, që të shmangen si banalizimi i fenomenit, ashtu edhe lëndimi i panevojshëm i personave të përmendur në artikull.
- Të përmirësohet përdorimi i fotove klishe dhe atyre abuzive.
- Të botohen përgënjeshtime apo korigjime në rast se kërkohen nga palët e dëmtuara, apo edhe me vetë vullnetin e gazetës.

Për autoritetet zyrtare:

- Të respektohet dhe zbatohet gjithnjë e drejta për informacion sipas ligjit në fuqi, sidomos me gazetarët.
- Të kërkojnë një identifikim më të plotë të burimeve zyrtare në marrëdhëniet e tyre me gazetarët.
- Të shmangin sa herë të mundin dhënien e informacionit ku nuk mund të citohet burimi.
- Të japin informacionin dhe ndihmesën e tyre për gazetarët që duan të bëjnë raporte të zgjeruara ose të cojnë më tej gazetarinë investigative.
- Të mos ushtrojnë asnjë lloj presioni ndaj gazetarëve.
- Të kërkojnë përgënjeshttrim në rast se shtypi ka dhënë informacion të gabuar.